

**Fakulteti i Shkencave Mjekësore**  
**Programi Studimor-Biomedicinë**  
**Cikli i tretë i studimeve të Doktoraturës**

**Fakultetit të Shkencave Mjekësore**  
**Këshillit Mësimor Shkencor të FSHM-së**  
**Tetovë**

Në bazë të Vendimit të datës 30.12.2019 për vlerësimin e punimit të disertacionit të doktoraturës të kandidatit **Nexhbedin Abazi** të miratuar nga *Këshilli-Mësimor Shkencor i Fakultetit të Shkencave Mjekësore të Universitetit të Tetovës*, u formua **Komisioni për vlerësimin e punimit të disertacionit të doktoraturës të kandidatit Nexhbedin Abazi** në përbërje: **Prof.Dr. Lutfi Zylbeari, Prof. Dr Nexhbedin Beadini, Prof.dr Kastriot Haxhirexha, Prof.Dr Nevzat Elezi, Prof. Dr Sadi Bexheti** Komisioni për vlerësimin e punimit të disertacionit të doktoraturës pas shqyrtimit të kërkesës të kandidatit **Nexhbedin Abazi** paraqet këtë:

### **Raport**

për vlerësimin e punimit të disertacionit të doktoraturës të kandidatit **Nexhbedin Abazi** me titull: *„Risk faktorët potencial për sëmundjet kardiovaskulare tek grupmoshat dhe gjinitë e ndryshme njerëzore”*

Punimi i disertacionit të doktoraturës së kandidatit **Nexhbedin Abazi** si në aspektin stukturor po ashtu edhe në aspektin përmbajtësor dhe hulumtues-shkencor i plotëson kriteret e një punimi të mirëfilltë të doktoraturës.

Punimi i disertacionit të doktoraturës është i konceptuar në *Kapituj* dhe *Nënkapituj* dhe në kuadër të punimit janë përfshi: *145 faqe, 8 tabela, figura 20 dhe 11 grafikone.*

Punimi i disertacionit të doktoraturës së kandidatit **Nexhbedin Abazi** është i strukturuar për nga aspekti përmbajtësor dhe metodologjik në: *Hyrje, Materiali dhe metoda e punës, Qëllimi i punës, Rezultatet, Diskutimi, Përfundimi, Summary dhe Literatura.*

## I. HYRJA

Tek „ **Hyrja**„ kandidati **Nexhbedin Abazi** ka paraqet në mënyrë të thuktë problematikën kryesore të disertacionit të doktoraturës duke përshkruar tematika të problematikës së punimit të disertacionit të doktoraturës dhe ka cituar literaturë të shkëputur nga tematika e fushës përkatëse dhe të fushës së ngushtë të kësaj lëmie shkencore hulumtuese. Kandidati ka potencuar faktorë të riskut potencial të sëmundjeve kardiovaskulare dhe ka cituar fragmente të rëndësishme nga literatura vendase dhe botërore për ti dhënë edhe një karakter më bindës punës hulumtuese të këtij disertacioni të doktorature.

Sistemi Kardiovaskular – SKV përfshinë zemrën , arteriet , kapilarët dhe venat e të qarkullimeve :

1. Qarkullimi Organor ose i Madh (Sistemik)
2. Qarkullimi Mushkëror ose i vogël (Pulmonar)

Sistemi Kardiovaskular shpërndan edhe mbledh gjakun në tërë pjesët e trupit.

Trendet bahskëkohore të jetesës , mënyra e të ushqyerit , faktori social , pirja e duhanit , mosaktiviteti fizik dhe shumë faktorë të tjerë mund të jenë si shkaktar potencial për sëmundjet kardiovaskulare . Varësisht nga veprimi këto faktorë mund të kenë karakter ekzogjen dhe endogjen , prandaj detektimi i hershëm i këtyre faktorëve mund të konsiderohet si masa paraprake dhe të mirëfillta për identifikimin e hershëm të këtyre sëmundjeve.

Vitet e 70-ta të shekullit të kaluar llogariten si vite ku SKV marin hov dhe manifesohen në formë të një epidemie jointektuese në përmasa botërore me theks të veçantë në vendet e industrializuara . Paraqitja në përmasa botërore e sëmundjeve të zemrës dhe enëve të gjakut që rezultojnë me mortalitet të lartë paraqitet si pasojë e industrializimit të shpejtë , rritjes së

standartit jetësor të një pjese të popullatës , ndryshimit të kushteve jetësore , stresit të rritur tek njeriu i industrializuar , papunësia e shtuar , ushqimi , kushtet e jetesës etj.

## II. QËLLIMI I PUNIMIT

Tek „ **Qëllimi i hulumtimit,** kandidati **Nexhbedin Abazi** paraqet në mënyrë të thuktë problematikën kryesore të qëllimit të punimit të disertacionit të doktoraturës duke përshkruar qëllimin esencial të fushës shkencore hulumtuese të këtijë punimi. Sidomos fokusimi i qëllimit të punimit është mbështetur në problematikën e fushës së kardiologjisë dhe sidomos në fushën e sindromit metabolik dhe faktorëve të rizikut potencial të sëmundjeve kardiovaskulare. Me theks të veçantë kandidati potencon preventivën e sëmundjeve kardiovaskulare dhe masat e duhura që ndërmëren për detektimin dhe zbulimin e hershëm të këtyre sëmundjeve që janë vdekjepruese për pacientët.

Dislipidmeitë paraqesin faktorë të rëndësishëm rreziku në paraqitjen e sëmundjeve kardiovaskulare . Ndryshe dislipidemitë definoohen si gjendje patologjike të përcjellura me vlera të larta të kolesterolit total triglicerideve, fraksionit pre Beta dhe LDL holestreolit , zvogëlim të vlerave të fraksionit alfa dhe HDL kolesterolit. Është e vërtetuar se obezitetet kanë vlera të ulëta të alfa lipoproteinave ( $p < 0.05$ ) në krahasim me ato që kanë peshë trupore normale. Pre  $\beta$  fraksioni është në korelacion me BMI  $r = 0.24$ ), ndërsa HDL holesteroli qëndron në korelacion negative me BMI ( $r = -0.22$ ). Në basë të rezultateve të fituara lind nevoja për screening të statusit lipidik tek popullata adulte dhe aplikimi i regjimit higjieno-dietike, ku përfshihet ushqimi i balancuar i cili do t'i sigurojë organizmit të njeriut sasi të mjaftueshme të acideve yndyrore omega 3.

Ne baze te studimit te Instituti i higjienes dhe mbrojtja e ambientit jetesor, Fakulteti i Mjekësisë në Sarajevë, publikuar me 20.04.2005: rreziku nga paraqitja sëmundjeve te zemrës dhe eneve të gjakut është më i madh në rastet e holesterolemisë nga 5.2-6.2 mmol/L. Sipas këtij studimi incidenca e paraqitjes së hiperholesterolemisë nuk dallon shumë sa i përket gjinisë, 33,03% të burrave kanë qenë me vlera të larta të lipidogramit, dhe 37,48% të grave. Sipas screening studimit CINDI (program i rizik-faktorëve në Sarajevë, e realizuar në vitin 2000 dhe 2001), përqindja e popullatës së përfshirë nga hiperlipidemia është 25%, ndërsa popullata adulte që

vuan nga obeziteti është 50%.. Me rritjen e viteve, rriten edhe vlerat e kolesterolit në plazmë të të dy gjinitë, por jo njëllëj. Tek meshkujt kolesterolit dhe LDL kanë vlera maksimale deri në dekadën e gjashtë të jetës, ndërsa tek femrat vlerat maksimale vazhdojnë edhe në dekadën e shtatë. Sipas këtij studimi në grupmoshën 40-49 vjeçare janë vërejtur vlera kërcënuese të fraksionit alfa , pre beta dhe HDL , në krahasim me grupmoshat më të reja ose më të vjetra , ko ka lidhshmëri me konsumimin e ushqimit të pasur me karbohidrate dhe yndyrna në atë periudhë të jetës.

Vlerat e rritura të kolesterolit edhe tek meshkujt edhe tek femrat në të gjitha grupmoshat e rrisin në mënyrë progressive rrezikun nga SKV, prandaj është i rëndësishëm screeningu i popullatës së re, me qëllim të ndryshimit të mënyrës së të jetuarit (lifestyle), por nëse është e nevojshme edhe aplikimin e terapisë.

### III. METODA E HULUMTIMIT

Tek „ **Materiali dhe metoda hulumtuese**„ kandidati **Nexhbedin Abazi** paraqet në mënyrë të theksuar problematikën kryesore të metodologjisë hulumtuese të disertacionit të doktoraturës duke përkrahur në mënyrë decise metodologjinë kryesore të fushës së ngushtë të kësaj lëmie shkencore hulumtuese. Kandidati ka përdorur metodologjinë më bashkëkohore për hulumtim duke u bazuar në metodat më të përsosura për hulumtim të mirëfilltë të kësaj problematike hulumtuese shkencore.

Në këtë hulumtim klinik prospektiv, observues, krahasues, i randomizuar dhe i kontrolluar janë analizuar 106 pacientë, prej të cilëve 61 meshkuj dhe 45 femra, me moshë mesatare 65.8 vjeç, të hospitalizuar në Spitalin Klinik të Tetovës, Reparti i Sëmundjeve Interne – Njësia Koronare, i realizuar gjatë periudhës qershor 2013 – qershor 2014.

Në secilin pacient janë realizuar këto ekzaminime kliniko-laboratorike: anamneza dhe statusi klinik, elektrokardiogrami- ECG, përcaktimi i aktivitetit katalitik të enzimeve: CPK, CK-MB, Troponina I dhe Troponina T, përcaktimi i koncentrimin të glukozës në serum, përcaktimi i kolesterolit, triglicerideve, HDL, LDL dhe lipideve totale, përcaktimi i BMI (body mass index-it), duhanpirja.



Anamneza (nga fjala greke "kujtim") është një angazhim i përbashkët si i mjekut, ashtu edhe i pacientit, me qëllim që, duke u bazuar në rrefimet dhe përgjigjet e të sëmurit, të formohet një ide mbi gjendjen shëndetësore të të sëmurit. Mendohet se anamneza ka vlerë më të rëndësishme në vënien e diagnozës (50-70%). Me qëllim që marrja e anamnezës të bëhet sa më e logjikshme dhe më e kuptueshme, autore të ndryshëm kanë parashtruar skema të ndryshme, të cilët në përgjithësi konsistojnë me këtë rradhitje: gjeneraliet e pacientit, ankesat kryesore, anamnesis morbid, anamnesis vitae, anamnesis familliare, anamneza socio-epidemiologjike

Pastaj vijon gjendja e tanishme (status praesens): përshtypja e përgjithshme, pozita në shtrat, vetëdija, të folurit, konstitucioni trupor, ekuilibri hidrik, frymëmarrja dhe ekzaminimi objektiv sipas sistemeve (koka, fytyra, qafa, kafazi i krahavorit, mushkëritë, zemra, abdomeni, aparati lokomotor, statusi neurologjik dhe psiqik).

Pacientët e hospitalizuar në Repartin Internistik të cilët janë pjesë e këtij hulumtimi kanë qenë me anamneze positive, me ankesat si vijojnë: dhimbje në gjoks, në krahun e majtë, shpinë, qafë me anamneza pozitive , me ankesat si vijojnë : dhimbje në gjoks , në krahun e majtë , shpinë, qafë , shpatulla, frymëmarrje evështirësuar, molisje dhe djersë të ftohta , dhimbje të epigastrium dhe discomfort i përgjithshëm.

#### IV. REZULTATET DHE DISKUTIMI

Tek „ **Rezultatet**„ kandidati **Nexhbedin Abazi** ka paraqitur dhe ka ilustruar në mënyrë tabelarësh, grafikonesh dhe figurave problematikën kryesore të fushës së ngushtë të kësaj lëmie shkencore hulumtuese. Rezultatet e fituara i ka shprehur në formë të ilustrimeve të qartësuar me vlera referente dhe vlera të fituar të cilat shprehin vlera determinante për diagnostifikimi e hershëm dhe të saktë të kësaj problematike.

Rezultatet e paraqitura nëpërmjet tabelave, grafikoneve dhe figurave janë të përpunuara me anë të metodologjisë më të sofistikuar *p value* dhe vlerave referente botërore. Këto rezultate do të japin një kontribut të çmuar për diagnostifikimin e sëmundjeve që janë të lidhura me sindromin

metabolik dhe sidomos tek sëmundjet kardiovaskulare. Rezultatete fituara do ti shërbejnë fushës së mjekësisë në përgjithësi dhe fushës së kardiologjisë në veçanti.

Tek diskutimi kandidatja ka parqitur në mënyrë shumë të detajuar problematikën e fushës hulumtuese dhe ka bë krahasimin e rezultateve me shumë autor të vendit dhe sidomos me theks të veçantë potencojme krahasimin e vlerave të kandidatës me vlerat referene të shume autoreve boteror që merren me problematikëne kësaj fushe hulumtuese.

## V. PËRFUNDIMI

Tek „ **Përfundimi,**” kandidati **Nexhbedin Abazi** paraqet në mënyrë të thuktë problematikën kryesore dhe përfundimtare të tematikës së disertacionit të doktoraturës duke dhënë rekomandimet përfundimtare dhe finale të fushës së ngushtë të kësajë lëmijë shkencore hulumtuese. Rezultatet e fituara kandidati gjithashtu i ka shprehur me ilustrime shumë decide për të sjellur konkudimet e duhura dhe të mirëfillëta për këtë fushë hulumtuese shkencore.

Në bazë të hulumtimeve të bëra te pacientët e grupmoshave dhe gjinive të ndryshme të analizuar për statusin lipidik holesterol, triglyceride, lipoproteina me densitet të lartë, lipoproteina me densitet të ulët, pacientët e analizuar për hipërtension, sëmundjet kardiovaskulare, indeksin e masës trupore dhe prevalencën e duhanpirjes te grupmoshat e ndryshme te pacientët e atakuar në spitalin klinik të Tetovës erdhëm në përfundim:

- Vlerat e holesterolit tek pacientët e analizuar te gjinise mashkullore tregojnë se vlera e holesterolit është  $\leq 5.2$  mmol/L = 45.9 % e te ekzaminuarve dhe te grupa e dytë me hipërholesterolemi është  $> 5.2$  mmol/L = 54.1 % e pacientëve te ekzaminuar.
- Vlerat e holesterolit tek pacientët e ekzaminuar t e gjinise femerore tregojnë se vlera e holesterolit është  $\leq 5.2$  mmol/L = 46.7 % e te ekzaminuarve dhe te grupa e dytë me hipërholesterolemi është  $> 5.2$  mmol/L = 53.3 % e pacientëve te ekzaminuar.
- Vlerat e holesterolit tek pacientët e ekzaminuar t e gjinise femerore tregojnë se vlera e holesterolit është  $\leq 5.2$  mmol/L = 46.7 % e te ekzaminuarve dhe te grupa e dytë me hipërholesterolemi është  $> 5.2$  mmol/L = 53.3 % e pacientëve te ekzaminuar.

- Vlerat e triglicerideve tek pacientët e ekzaminuar te gjinise femerore me vlera normale referente janë  $\leq 1.7$  mmol/L = 44.4% e pacientëve te ekzaminuar dhe me hipërtrigliceridemi  $> 1.7$  mmol/L = 55.6 % e pacientëve te ekzaminuar.
- Vlerat e triglicerideve tek pacientët e ekzaminuarit e gjinise mashkullore me vlera normale referente janë  $\leq 1.7$  mmol/L = 52.5 % e pacientëve te ekzaminuar dhe me hipërtrigliceridemi  $> 1.7$  mmol/L = 47.5 % e pacientëve te ekzaminuar.
- Vlerat e HDL- së tek pacientët e ekzaminuar te gjinise mashkullore janë  $< 0.9$  mmol/L Rrezik i lartë = 44.3 % e pacientëve te ekzaminuar, 0.9-1.6 mmol/L = 50.8 % e te ekzaminuarve,  $> 1.6$  mmol/L = 4.9 % e te ekzaminuarve (normal).
- Vlerat e HDL –së tek pacientët e ekzaminuarit te gjinise femerore janë  $< 0.9$  mmol/L Rrezik i lartë = 44.4 % e te ekzaminuarve, 0.9-1.6 mmol/L = 55.6 % e te ekzaminuarve,  $> 1.6$  mmol/L = 0 % e te ekzaminuarve (normal).
- Te gjinia mashkullore, prej 61 pacientëve të ekzaminuar 33 prej tyre kanë pasur të rritur nivelin e enzimeve në gjak, që dmth. se te këto pacientë kanë pasur nekrozë të miokardiociteve. Prej 45 pacientë të gjinisë femërore, me nivel të rritur të enzimeve (dmth. me nekrozë të miokardiociteve) kanë qenë vetëm 9 pacientë.

## VI. BIBLIOGRAFIA

Tek „ **Bibliografia,** kandidati **Nexhbedin Abazi** paraqet në mënyrë të thuktë problematikën kryesore të tematikës së disertacionit të doktoraturës duke përshkruar dhe cituar literaturë përkatëse të fushës së ngushtë të kësajë lëmijë shkencore hulumtuese.

Tek ky punim doktore do të fokusohemi në literaturën më standarde më bashkëkohore dhe në mënyrë të drejtë do të citohen referencat e punimit të doktoraturës. Këto referenca të cituara do ta plotësojnë dhe do ti japin një karakter edhe më përmbajtësorë punimit të doktoraturës sepse do tu përkasin referencave më bashkëkohore të cituara me impakt ndërkombëtar, prandaj duke u parë edhe nga ky aspekt ky punim do ti plotëson të gjitha standardet bashkëkohore të një punimi të mirëfilltë të doktoraturës.

Dukë u bazuar në të dhënat disertacionit të doktoraturës, konsiderojmë se ky punim i doktoraturës do të sjellë një risi tek risk faktorët potencial për sëmundjet kardiovaskulare tek grupmoshat dhe gjinitë e ndryshme njerëzore e cila do të sjellë një risi tek problematikat e sëmundjeve kardiovaskulare në veçanti në fushën e mjekësisë në përgjithësi, prandaj kërkojë nga *Këshilli Mësimor Shkencor të Fakultetit të Shkencave Mjekësore*, që ta pranojë dhe miratojë punimin e disertacionit të doktoraturës të kandidatit *Nexhbedin Abazi* me titull: *Risk faktorët potencial për sëmundjet kardiovaskulare tek grupmoshat dhe gjinitë e ndryshme njerëzore*”.

Tetovë më, 27.01. 2020

Anëtarët e komisionit:

Prof. Dr. Lutfi Zylbeari




---

Prof. Dr. Nexhbedin Beadini



---

Prof. Dr. Kastriot Haxhirexha



---

Prof. Dr. Nevzat Elezi



---

Prof. Dr. Sadi Bexheti



---